VENDIM
Nr. 10, datë 28.2.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahimi	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 28.2.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (K) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Kujtim Kllogjeri, përfaqësuar nga avokat Redi Ramaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokuror Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-183, datë 31.1.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 27, 29, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Kujtim Kllogjeri, *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I

Rrethanat e çështjes

1. Në ngarkim të kërkuesit, me detyrë administrator në shoqërinë ndërtuese "G&Xh", Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar për gjykim në këtë gjykatë çështjen penale nr. 1622 të vitit 2014, për veprat penale "Mashtrimi" me pasoja të rënda dhe "Mashtrimi" më shumë se një herë, të parashikuara nga neni 143/2 i Kodit Penal *(KP)*.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2015-5248) 1051, datë 5.11.2015, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprat penale "Mashtrimi" me pasoja të rënda dhe "Mashtrimi" në dëm të disa personave, të dyja të parashikuara nga neni 143/2 të KP-së dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim për veprën e parë dhe 6 (gjashtë) vjet burgim për veprën e dytë penale. Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të KP-së, gjykata ka vendosur dënimin e tij me 12

(dymbëdhjetë) vjet burgim, duke arsyetuar se kërkuesi ka përvetësuar pasurinë e shumë personave në kushtet e mirëbesimit, duke u shkaktuar dëm në vlera të mëdha. Po kështu, përmes veprimeve aktive të kundërligjshme, ai ka arritur të mashtrojë edhe shumë të tjerë, të cilëve u ishin premtuar viza pune për në Kazakistan kundrejt pagesës. Për sa i përket llojit të dënimit, ndërmjet alternativave të parashikuara në nenin 143/2, të KP-së, ajo ka vlerësuar se për një arritje sa më të plotë të qëllimit të dënimit, ai duhet të jetë me burgim në masë të lartë, që shkon proporcionalisht me rrezikshmërinë e lartë shoqërore të veprës penale të kryer prej tij. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar ankim.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2017-297, datë 10.2.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke arsyetuar, ndër të tjera, se ky vendim është i drejtë edhe për sa i përket masës së dënimit në funksion të individualizimit të tij, duke respektuar drejt llojin dhe kufijtë e masave të dënimit të parashikuara nga dispozita konkrete, neni 143/2, i KP-së, si dhe kriteret e parashikuara në nenin 47 të KP-së. Kundër këtij vendimi, në datën 6.3.2017 kërkuesi ka ushtruar rekurs, i cili është plotësuar në vijim nga përfaqësuesi ligjor i kërkuesit në datën 27.3.2017.

4. Në datën 20.1.2022 kërkuesi ka paraqitur shtesë rekursi, ku ka ngritur pretendimin për zbatimin e ligjit penal favorizues ndaj tij, pasi nëpërmjet ligjit nr. 36/2017, datë 30.3.2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" *(ligji nr. 36/2017),* neni 143 i KP-së që parashikon veprën penale "Mashtrimi" ka ndryshuar dhe është favorizues ndaj tij për sa i përket masës së dënimit.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-183, datë 31.1.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se nuk ka konstatuar shkelje të zbatueshmërisë së ligjit material më favorizues, në kuptim të nenit 3 të KP-së, me pasojë rëndimin e pozitës së të gjykuarit.

6. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 16.6.2023 me ankim kushtetues individual, me objekt shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Me vendimin e datës 29.9.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor dhe e drejta për gjykim të drejtë*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit dhe si rrjedhim e ka privuar atë nga e drejta që çështja e tij të gjykohej në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

7.2. *E drejta e lirisë personale*, e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se dënimi i dhënë ndaj kërkuesit është i përshtatshëm për sa kohë nuk e kalon limitin e parashikuar të dënimit të përcaktuar në nenin 143/3 të KP-së, pas ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 36/2017, ndërkohë që kërkuesi është dënuar në total me 12 vjet burgim, në kapërcim të maksimumit të dënimit prej 10 vjetësh të parashikuar për veprën penale sipas dispozitës së ndryshuar, që është favorizuese.

7.3. *Parimi i fuqisë prapavepruese i ligjit penal favorizues*, i garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka vepruar për zbatimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues gjatë gjykimit të çështjes, si rrjedhim i ndryshimit të masës së dënimit që parashikohej në nenin 143 të KP-së, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 36/2017. Ky ndryshim ligjor favorizues për kërkuesin ishte në fuqi në momentin që rekursi i tij gjykohej në këtë gjykatë.

8. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme****,* ka prapësuar si vijon:

8.1. *Për themelin e kërkesës*

8.1.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe së drejtës për gjykim të drejtë* është i pabazuar, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pas vlerësimit paraprak të shkaqeve të rekursit, ka çmuar se në të nuk ngrihen shkaqe të bazuara në ato të

parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale. Kërkuesi ka ngritur në rekurs pretendime që lidhen me vlerësimin e provave, të cilat dalin jashtë juridiksionit të kësaj gjykate. Shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Kjo gjykatë i ka garantuar kërkuesit të drejtën e aksesit në drejtim të së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë, si dhe të drejtën për mbrojtje efektive.

8.1.2. Pretendimi për cenimin *e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues*, të garantuar nga neni 29, i Kushtetutës, është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë nuk mund ta bëjë vlerësimin e bazueshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta mbi bazën e një ligji i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën e disponimit prej tyre. Vlerësimi i pretendimeve të ngritura nga kërkuesi në Gjykatën e Lartë do të duhet të bëhet në raport me ligjin e kohës dhe vendimi i gjykatës më të ulët është i cenueshëm vetëm nëse vjen në kundërshtim me të. Gjykata e Lartë nuk mund të cenojë një vendim të gjykatave më të ulëta bazuar në fakte legjislative të dala pas marrjes së vendimeve të tyre, pasi do të dilte jashtë funksioneve të saj kushtetuese si gjykatë ligji. Në këtë kuptim, kjo gjykatë nuk mund të prishë një vendim që është i drejtë dhe i bazuar, pasi në të kundërt do të krijonte shumë implikime, si në lidhje me sigurinë juridike ashtu edhe me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve. Ajo do të mund të zbatonte ligjin në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes prej saj vetëm në situatën e vlerësimit se vendimi i gjykatës më të ulët është i pabazuar në ligjin e kohës kur është marrë, por jo në rrethanat kur ai vendim është i bazuar. Në rastin konkret, arsyetimi i saj për ligjin favorizues vlerësohet si jo i drejtë, pasi pasqyron një kuptim të gabuar në lidhje me rolin dhe kufijtë e shqyrtimit të një çështjeje prej saj, si dhe pasqyron reminishencën e aktivitetit të Gjykatës së Lartë para ndryshimeve ligjore.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive,* që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, sipas të cilit individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë *(shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese).*

12. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të iniciuar prej tij. Në këtë situatë,

Gjykata vlerëson se ai nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar dhe, për rrjedhojë, ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor është përmbyllur me vendimin nr. 00-2023-183, datë 31.1.2023, të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që në bazë të verifikimeve të kryera ankimi kushtetues individual, i paraqitur në datën 2.6.2023, është dërguar me postë në datën 31.5.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000. Si rrjedhim, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

14. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

15. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe gjykim të drejtë, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit dhe si rrjedhim e ka privuar atë nga e drejta që çështja e tij të gjykohej në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese në mbështetje të pretendimit të tij, prandaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës për liri personale të parashikuar nga neni 27 i Kushtetutës, Gjykata konstaton se ndonëse në parim dhe në referencë të nenit 5, pika 1, shkronja "a", të KEDNJ-së, liria personale nuk mund të konsiderohet e kufizuar në rastet kur personi burgoset ligjërisht si pasojë e një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente, duke pasur parasysh se kërkuesi pretendon se si rezultat i cenimit të parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues do të vuajë 2 (dy) vjet heqje të lirisë në mënyrë të paligjshme, Gjykata vlerëson që ta analizojë atë të lidhur me parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, të garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës.

17. Për sa më lart, Gjykata çmon të shqyrtojë në vijim bazueshmërinë në themel të pretendimeve të kërkuesit për cenimin e të drejtës për liri personale të lidhur me parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e të drejtës për liri personale të lidhur me parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues

18. Sipas kërkuesit, liria e tij personale është cenuar si rezultat i cenimit të parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka vepruar për zbatimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues gjatë gjykimit të çështjes, si rrjedhim i ndryshimit të masës së dënimit që parashikohej në nenin 143 të KP-së, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 36/2017. Ky ndryshim ligjor favorizues për kërkuesin ishte në fuqi në momentin që rekursi i tij gjykohej në këtë gjykatë. Ky kolegj ka vlerësuar se dënimi i dhënë ndaj kërkuesit është i përshtatshëm për sa kohë nuk e kalon limitin e parashikuar të dënimit të përcaktuar në nenin 143/3 të KP-së, pas ndryshimeve të pësuara me ligjin e mësipërm, ndërkohë që kërkuesi është dënuar në total me 12 vjet burgim, në kapërcim të maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën sipas dispozitës së ndryshuar, që është favorizuese.

19. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, Gjykata e Lartë nuk mund ta bëjë vlerësimin e bazueshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta mbi bazën e një ligji i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën e disponimit prej tyre. Vlerësimi i pretendimeve të ngritura nga kërkuesi në Gjykatën e Lartë do të duhet të bëhet në raport me ligjin e kohës dhe vendimi i gjykatës më të ulët është i cenueshëm vetëm nëse vjen në kundërshtim me të. Gjykata e Lartë nuk mund të cenojë një vendim të gjykatave më të ulëta bazuar në fakte legjislative të dala pas marrjes së vendimeve të tyre, pasi do të dilte jashtë funksioneve të saj kushtetuese si gjykatë ligji. Në këtë kuptim, kjo gjykatë nuk

mund të prishë një vendim që është i drejtë dhe i bazuar, pasi, në të kundërt, do të krijonte shumë implikime si në lidhje me sigurinë juridike, ashtu edhe me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve. Gjykata e Lartë do të mund të zbatonte ligjin në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes prej saj vetëm në situatën e vlerësimit se vendimi i gjykatës më të ulët është i pabazuar në ligjin e kohës kur është marrë, por jo në rrethanat kur ai vendim është i bazuar. Po sipas subjektit të interesuar, në rastin konkret arsyetimi i saj për ligjin favorizues vlerësohet si jo i drejtë, pasi pasqyron një kuptim të gabuar në lidhje me rolin dhe kufijtë e shqyrtimit të një çështjeje prej saj, si dhe pasqyron reminishencën e aktivitetit të Gjykatës së Lartë para ndryshimeve ligjore.

20. Liria personale është e garantuar nga neni 27, pika 1, i Kushtetutës, i cili parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Ajo mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në pikën 2 të tij, ku, ndër të tjera, përfshihet dënimi i individit me burgim nga gjykata kompetente (*shkronja "a"*). Gjykata ka theksuar se qëllimi kryesor i kësaj dispozite është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustifikuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një shoqëri demokratike. Në këtë drejtim është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë të jenë qartësisht të përcaktuara sipas ligjit të brendshëm dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, për t'i mundësuar individit që të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme, rrethanat dhe pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar *(shih vendimin nr. 39, datë 15. 2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Në lidhje me zbatimin e ligjit favorizues, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se neni 29 i Kushtetutës në pikën 3 parashikon se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Gjykata është shprehur se e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29, pika 3, të Kushtetutës, ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe, si e tillë, është e rëndësishme për respektimin e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor. Ky parim gjen zbatim vetëm për ligjet penale, arsye për të cilën dispozita kushtetuese reflektohet në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale (*shih vendimet nr. 2, datë 15.2.2017; nr. 1, datë 20.1.2014; nr. 14, datë 17.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të përsëritur se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale (*shih vendimet nr. 9, datë 26.2.2016; nr. 12, datë 19.3.2015; nr. 47, datë 27.6.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata rithekson se sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor dhe se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, interpretimi i ligjit material ose procedural është, së pari, detyrë e Gjykatës së Lartë. Gjykata ndërhyn vetëm atëherë kur, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese (shih vendimin nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese). Po kështu, Gjykata ka pohuar se respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 59, datë 16.9.2016; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata vëren se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 36/2017, paragrafi 2 i nenit 143 të KP-së ka ndryshuar, duke parashikuar masa më të ulëta dënimesh për veprën penale të mashtrimit të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, si dhe të mashtrimit me pasoja të rënda. Aktualisht dhe gjatë gjykimit të rekursit të kërkuesit në Gjykatën e Lartë, neni 143 i KP-së është ndryshuar në mënyrë thelbësore. Për sa i përket veprës penale "Mashtrimi" në rrethana cilësuese, ajo tashmë është

parashikuar në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 143 të KP-së. Konkretisht, paragrafi 2 i kësaj dispozite parashikon këtë vepër penale të kryer në rrethanat cilësuese "të bashkëpunimit" ose "më shumë se një herë", e cila dënohet me burgim nga 2 (dy) deri në 6 (gjashtë) vjet. Kurse paragrafi 3 i kësaj dispozite parashikon këtë vepër penale të kryer në rrethanën cilësuese "kur vepra ka sjellë pasoja të rënda", e cila dënohet me burgim nga 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë) vjet. Ndërkohë, dënimi përfundimtar për kërkuesin është dhënë mbi bazën e ligjit penal të kohës kur ai është gjykuar. Në vitin 2015 vepra penale "Mashtrimi" në rrethana cilësuese parashikohej në paragrafin 2 të nenit 143 të KP-së, ku pjesa e parë e këtij paragrafi parashikonte këtë vepër penale të kryer në rrethanat cilësuese "të bashkëpunimit" ose "më shumë se një herë", e cila dënohej me burgim nga 3 (tre) deri në 10 (dhjetë) vjet, ndërsa pjesa e dytë e këtij paragrafi parashikonte këtë vepër penale të kryer në rrethanën cilësuese "kur vepra ka sjellë pasoja të rënda", e cila dënohej me burgim 10 (dhjetë) deri në 20 (njëzet) vjet.

25. Gjykata konstaton se Kolegji Penal ka vlerësuar se kur ligji i kohës së kryerjes së veprës penale nga kërkuesi dhe ligji penal, aktualisht në fuqi në kohën e shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, ishin të ndryshëm, ndaj të gjykuarit duhej të zbatohej ligji, dispozitat e të cilit ishin më të favorshme, që në rastin konkret lidheshin me zbatimin e nenit 143, paragrafi 3, të KP-së, të ndryshuar me ligjin nr. 36/2017. Sipas këtij kolegji, duke iu referuar ndryshimeve të KP-së, por edhe dënimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, ku identifikohej dënimi prej 10 (dhjetë) vjetësh burgim për parashikimin e nenit 143, paragrafi 2, të KP-së (njëri prej dënimeve të dhëna për faktin penal të mashtrimit të individëve që kanë blerë apartamente), ky dënim quhej i përshtatshëm, për sa kohë nuk e kalonte limitin e parashikuar të dënimit me ndryshimet e pësuara të nenit 143, paragrafi 3, të KP-së (dispozita e re). Në këtë kuptim, Kolegji Penal nuk ka konstatuar shkelje të zbatueshmërisë së ligjit material favorizues, në kuptim të nenit 3 të KP-së, me pasojë rëndimin e pozitës së të gjykuarit.

26. Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, përfundimisht ka njohur zbatimin e dënimit me burgim të caktuar ndaj kërkuesit nga gjykatat e faktit, të cilat për një nga veprat penale i kanë caktuar atij dënim me 6 vjet burgim, dënim ky që sipas ligjit të kohës së kryerjes së veprës (neni 143, paragrafi 2, pjesa e parë e dispozitës) ka qenë ndërmjet marzheve të dënimit të parashikuar nga ligji (nga 3 gjer në 10 vjet burgim), ndërsa sipas ligjit aktual (neni 143, paragrafi 2) në masën maksimale të parashikuar prej tij (nga 3 gjer në 6 vjet burgim), kurse për një vepër tjetër penale i kanë caktuar atij dënim me 10 vjet burgim, dënim ky që sipas ligjit të kohës së kryerjes së veprës (neni 143, paragrafi 2, pjesa e dytë e dispozitës) ka qenë në minimumin e dënimit të parashikuar nga ligji (nga 10 gjer në 20 vjet burgim), ndërsa sipas ligjit aktual (neni 143, paragrafi 3) në masën maksimale të parashikuar prej tij (nga 5 gjer në 10 vjet burgim). Pra, nëpërmjet vendimit të tij Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka njohur zbatimin ndaj kërkuesit të masave maksimale të dënimit me burgim të parashikuara nga ligji aktual për ato vepra penale që ai është gjetur fajtor, në një kohë kur gjykatat e faktit, në aplikim të kritereve të individualizimit të dënimit, kanë urdhëruar zbatimin ndaj kërkuesit të dënimeve me burgim të cilat në raport me ligjin e kohës së kryerjes së veprave penale përfaqësonin një masë të ndërmjetme të dënimit për njërën nga ato dhe masën minimale të dënimit për tjetrën.

27. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se në kushtet kur shqyrtimi i çështjes së kërkuesit në Gjykatën e Lartë është kryer në kohën kur ligji penal favorizues kishte hyrë në fuqi, si dhe duke pasur parasysh se caktimi i masës së dënimit për kryerjen e një vepre penale në përputhje me marzhet e dënimit të parashikuara nga ligji për të është çështje ligji (jo fakti) dhe si e tillë është brenda sferës së përgjegjësive të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit duhej të kishte zbatuar vetë ligjin në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, duke individualizuar dënimin për secilën nga veprat për të cilat është dënuar kërkuesi dhe duke u siguruar që dënimi i tij jo vetëm të mos ishte në kapërcim të masës së dënimit të parashikuar nga ligji penal favorizues, por edhe në përputhje me kriteret e individualizimit të dënimit të aplikuara nga gjykata e faktit. Një gjë e tillë përputhet edhe me praktikën e mëparshme të ndjekur prej Gjykatës së Lartë, ku ajo vetë ka bërë individualizimin e masës së dënimit, duke mbajtur parasysh që rrethanat për caktimin e masës së dënimit, sipas nenit 47 të KP-së, janë përcaktuar nga pikëpamja

faktike nga gjykatat e faktit në bazë të provave të administruara dhe vlerësuara gjatë shqyrtimit në themel të çështjes. Në të tilla raste, Gjykata e Lartë, pa i hyrë vlerësimit të provave dhe fakteve, ka vlerësuar se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme për sa i përket masës së dënimit ka qenë i gabuar (*shih vendimet 00-2017-41 (7), datë 8.2.2017; 00-2017-42 (8), datë 8.2.2017; 00-2017-44 (11), datë 8.2.2017; 00-2017-44 (11), datë 8.2.2017; 00-2017-45 (12), datë 8.2.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Kjo do të thotë se individualizimi i dënimit lidhet me zbatimin e ligjit, dhe jo me vlerësimin e provave. Në kushtet kur vendimi i gjykatës së apelit, i pacenuar nga Gjykata e Lartë, ishte arsyetuar bazuar në ligjin e mëparshëm, Gjykata e Lartë nuk mund të mjaftohej vetëm me verifikimin formal që dënimi i dhënë ndaj kërkuesit nuk ishte në kapërcim të masës maksimale të dënimit të parashikuar nga ligji penal favorizues, por duhej të aplikonte masën e dënimit për secilën vepër penale bazuar në ligjin e ri penal favorizues në përputhje me kriteret e individualizimit sipas nenit 47 të KP-së dhe në vijim, në zbatim të nenit 55 të KP-së, të caktonte dënimin e tij përfundimtar. Dështimi i Gjykatës së Lartë për të zbatuar ligjin penal favorizues gjatë gjykimit të rekursit, duke sjellë si pasojë që kërkuesi të vuajë një masë dënimi në maksimumin e parashikuar nga ligji penal favorizues, por duke injoruar kriteret e individualizimit të dënimit të aplikuara nga gjykatat e faktit, përbën cenim të së drejtës për liri personale të kërkuesit në lidhje me parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues.

28. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për liri personale në lidhje me parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-183, datë 31.1.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 28.2.2024.
Shpallur më 2.4.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska